



K O N F E R E N C E

« Ekzekutimi i vendimeve të gjyqësorit: Garanci për një ekonomi efikase »

Hotel Plaza
Tirana, 26-27 tetor 2017

KONTEKSI I KONFERENCES

Kjo konferencë e organizuar me iniciativën e Dhomës Franceze të Përmbauesve Gjyqësorë (CNHJ- Francë), në partneritet me Fondacionin për të drejtën kontinentale (Francë) zhvillohet në kuadër të bashkëpunimit të iniciuar gjatë zbatimit të projektit të binjakëzimit të BE-së lidhur me « përmirësimin e sistemit të ekzekutimit të vendimeve të gjyqësorit në Shqipëri » (i implementuar nga Justice Coopération Internationale, agjencia e Ministrisë franceze të drejtësisë për menaxhimin e projekteve ndërkombëtare në fushën e drejtësisë). Gjatë këtij projekti binjakëzimi, i cili zgjati nga qershori 2015 deri në tetor 2016, sistemit përmbaues shqiptar iu ofrua ekspertiza më e mirë europiane nëpërmjet ekspertëve të Dhomës Franceze të Përmbauesve Gjyqësorë dhe homologëve të tyre hollandezë.

Nga ana tjetër, Dhoma Franceze e Përmbauesve Gjyqësorë ka nënshkruar me datë 12 maj 2017, një marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë shqiptare të Drejtësisë, me qëllim që të vazhdojë dhe të intensifikojë shkëmbimet e ekspertizës mes dy vendeve, që do të shoqërojnë Shqipërinë në reformat e ndërmarra në fushën e ekzekutimit të vendimeve të gjyqësorit dhe rritjes cilësore të profesionalizmit të përmbauesve.

OBJEKTIVAT E KONFERENCES

Objektivi kryesor i konferencës është të realizojë një bilanc të situatës së profesionit të përmbauesit gjyqësor në Shqipëri (shtetërore dhe private), si dhe procedurave përmbauese gjatë kësaj periudhe 1-vjeçare nga përfundimi i projektit të binjakëzimit të BE-së për përmbauesit.



Nga rekomandimet e prezantuara Ministrisë shqiptare të Drejtësisë nga ekspertët francezë dhe hollandezë të projektit mund të përmendim disa prej më kryesoreve:

Vënia në zbatim e një aksesit të sigurtë elektronik për noterët dhe përmbaruesit në regjistrat e hipotekës (ZRRP), ngritja e një Qendre Kombëtare të Ankandëve Publike, vënia në funksionim të sistemit elektronik ALBIS, në Ministrinë e Drejtësisë, ku do të regjistrohen elektronikisht të dhënat e dosjeve përbarimore, fuqizimi i trupës së përmbaruesve shtetërorë me burime financiare, njerëzore, pajisje kompjuterike si dhe një akses të plotë në regjistrat elektronikë shtetërorë, ngritja e strukturave të qëndrueshme për organizimin e trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme për përmbaruesit, hartimi i një kodi të ri të etikës për përmbaruesit, si dhe vënia në zbatim të procedurave disiplinore solide, në përputhje me standardet europiane.

Personalitetet franceze dhe shqiptare, që do të marrin fjalën gjatë dy ditëve të punimeve të konferencës duke adresuar tema të ndryshme me interes për profesionin, përpara se të trajtojnë temën thelbësore të zhvillimit të sistemeve elektronike në aktivitetin e përmbaruesve, në shërbim të qytetarëve dhe profesionistëve të tjerë të sistemit të drejtësisë. Krijimi i sistemeve elektronike të sigurta mes aktorëve të ndryshëm, që marrin pjesë në procedurat e ekzekutimit përbën në fakt një nga sfidat madhore për Shqipërinë, në perspektivën e saj të anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Gjatë ceremonisë së hapjes së konferencës, me datë 26 tetor 2017, personalitetet e larta shqiptare, përfaqësuesit e Bashkimit Europian dhe personalitetet e larta franceze do të prezantojnë kuadrin dhe objektivat e kësaj konference.

Gjatë ditës së dytë të konferencës, me datë 27 tetor 2017, punimet do të organizohen rreth dy tryezave të rumbullakëta të ndara në panele të ndryshme që kanë të bëjnë me:

“profesionistët e ekzekutimit në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve”, më tej “teknologjitë e reja në shërbim të rritjes së efikasitetit të përmbaruesve”, të ndjekura nga dy panele tematike mbi: “metodat e trajnimeve” dhe “shitjet në ankand”.